

Gjykata Supreme e Kosovës
AP – KŽ. Nr. 24/2010
4 maj 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në kolegjin përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Norbert Koster si Kryetar i Kolegjit, me Gjyqtarët e EULEX-it Maria Giuliana Civinini dhe Guy Van Craen dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Valdete Daka dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, asistuar nga Valentina Gashi si procesmbajtëse,

në lëndën penale kundër të pandel PD mri i të atit
, mbiemri i vajzërisë i se emes , i lindur më
në , Republika e Serbisë, me kombësi Serbe dhe shtetësi Serbe, vendbanimi i
fundit i njohur në fshatin , Komuna , Republika e Serbisë, i pamartuar,
shkollimi tre (3) vjet shkollë profesionale, i papunë, nuk është i dënuar më parë,

i mbajtur në paraburgim që prej datës 14 qershor 2008,

i akuzuar për veprë penale Nxitje e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik, në kundërshtim të nenit 115 paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), Kryerje të veprës terroriste, në kundërshtim të nenit 110 paragrafët 2 dhe 1 në lidhje me nenin 109 paragrafin 1, nënparagrafin 2, 7 dhe 10 të KPK-së, Vrasje e rëndë në tentativë, në kundërshtim të neneve 146 dhe 147 në lidhje me nenin 20 të KPK-së,

duke vendosur pas ankesës së paraqitur nga Avokatët mbrojtës Ljubomir Pantović dhe Miodrag Brkljač, të datës 31 dhjetor 2009, në emër të të pandehurit, dhe pas ankesës, të datës 27 janar 2010, të paraqitur nga E dhe A si palë të dëmtuara, kundër Aktgjykimit P. Nr. 134/2008, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë më 19 nëntor 2009,

në seancën e mbajtur më 04 maj 2010, pas këshillimit dhe votimit lëshon këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga Avokatët mbrojtës Ljubomir Pantović dhe Miodrag Brkljač në emër të të pandehurit, **refuzohet**.

Ankesa e paraqitur nga A si palë e dëmtuar **hedhet poshtë si e paafatshme**.

Ankesa e palës së dëmtuar E **pranohet**. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i datës 19 nëntor 2009, **ndryshohet pjesërisht**. Për Pikën B – Vrasje e rëndë në tentativë në kundërshtim të nenit 147 pika 10 e KPK-së – i akuzuari dënohet me

dymbëdhjetë (12) vjet burgim,

duke rezultuar me një dënim unik prej

dymbëdhjetë (12) vjet e tre (3) muaj burgim.

Sa i përket pjesëve të mbetura Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i datës 19 nëntor 2009, vërtetohet.

Arsyetim:

I. Historia e Procedurës

Më 16 qershor 2008, Prokurori Publik Shyqyri Shala nga Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë lëshoi një Aktvendim mbi Fillimin e Hetimit kundër të pandehurit. Më 12 dhjetor 2008, Prokurori Publik Shyqyri Shala paraqiti një aktakuzë kundër të pandehurit për veprat penale Nxitje e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik, dhe Kryerje të veprës terroriste.

Më 16 prill 2009, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) morri përsipër këtë lëndë.

Më 02 korrik 2009, është paraqitur një aktakuzë e ndryshuar, duke akuzuar të pandehurin edhe për veprat penale të Vrasjes së rëndë në tentativë.

Aktakuza e ndryshuar u konfirmua nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë me Aktvendimin, e datës 06 korrik 2009.

Shqyrtimi gjyqësor u mbajt mes datave 27 korrik dhe 19 nëntor 2009. Kolegji më 19 nëntor 2009 shpalli të pandehurin fajtor për veprën penale Nxitje e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik, dhe Vrasje të rëndë në tentativë. Akuza për Kryerje të veprës terroriste u refuzua sipas nenit 389 pika 1 e KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë shqiptoi dënime të vetme nga gjashtë (6) muaj për veprën penale Nxitje e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik, dhe gjashtë (6) vjet për veprën penale Vrasje të rëndë në tentativë ndaj të akuzuarit. Gjykata konsideron se rrethanat lehtësuese peshojnë më shumë se rrethanat rënduese dhe, duke u bazuar në nenin 66 dhe 67 të KPPK-së, ndaj të pandehurit shqiptoi një dënim më të vogël se minimumi i përshkruar me ligj.

Më 5 janar 2010 Avokatët mbrojtës Ljubomir Pantović dhe Miodrag Brkljač në emër të të pandehurit paraqitën ankesë kundër aktgjykimit. Kjo ankesë ishte paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë më 11 janar 2010. Më 27 janar 2010 E... dhe A... si palë të dëmtuara paraqitën ankesë kundër aktgjykimit.

II. Çështjet e ngritura në ankesa:

Avokatët mbrojtës Ljubomir Pantović dhe Miodrag Brkljač propozojnë të merret një vendim që do të ndryshonte Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë sa i përket Pikës B – Vrasje e rëndë në tentativë – duke e shpallur të pandehurin fajtor për vepër penale Lëndim i rëndë trupor në kundërshtim të nenit 154 paragrafi 1 pika 1 e KPK-së dhe shqiptuar një dënim më pak të ashpër.

Avokatët mbrojtës pretendojnë në shkelje të Ligjit Penal, sepse Gjykata e shkallës së parë është dashur ta shpallë të pandehurin fajtor për Lëndim të rëndë trupor kurse jo për vrasje të rëndë në tentativë. I pandehuri nuk ishte i vendosur të privojë viktimën E... nga jeta e tij. Ai shkrep vetëm një (1) të shtënë e cila nuk e vrau viktimën. Plumbi i dytë mbeti në tytën e armës. Nga ekspertiza balistike rezulton se pistoleta e të pandehurit ishte në gjendje të mirë. Kështu që ai ka mundur të qëllojë herën e dytë.

Avokatët mbrojtës më tutje pretendojnë se dënimi për këtë vepër nga i akuzuari është shumë i lartë, madje edhe nëse cilësimi juridik i gjykatës së shkallës së parë do të përkrahej. Fakti që E... pësoi lëndim të rëndë trupor nuk mund të paraqesë rrethanë rënduese, sepse lëndimet e tilla janë pasoja të rregullta të përdorimit të armëve të zjarrit. Pasojat e mundshme afatgjate nga kjo plagë janë hipotetike dhe prandaj nuk mund të paraqesin një rrethanë rënduese.

Palët e dëmtuara propozojnë ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shqiptimin e një dënimi më të ashpër ndaj të pandehurit. Ata pohojnë se dënimi i shqiptuar është nën minimumin e paraparë. Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka tejkaluar autorizimet ligjore për një dënim më të butë. Rrethanat lehtësuese janë mbivlerësuar kurse rrethanat rënduese nuk janë marrë parasysh si duhet. Në veçanti gjykata e shkallës së parë është dashur të merr parasysh:

- vendosmërinë e të pandehurit për të shkuar te minarja e xhamisë duke u ngjitur nga jashtë,
- faktin që i pandehuri ka ngritur flamurin e një grupi tjetër etnik me besim tjetër fetar në minaren e xhamisë në qytet ku marrëdhëniet ndëretnike janë shumë të tensionuara, të rënda,
- faktin se i akuzuari është shtirë si shurdhmemec kur ka kontaktuar policët, duke vepruar në këtë mënyrë i ka mashtruar ata lidhur me gjendjen e tij,
- përkushtimin për të hyrë medoemos në Stacionin e Policisë me thikë në dorë pas lëndimit të Policit E

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) me mendimin e datës 23 shkurt 2010, të paraqitur në Gjykatën Supreme më 30 mars 2010, thotë se ankesa e paraqitur nga avokatët mbrojtës nuk është e bazuar. Veprimi i të pandehurit – me një (1) të shtënë nga afërsia në drejtim të Policit E – nuk lejon ndonjë përfundim tjetër përveç qëllimit të tij për ta privuar viktimën nga jeta e tij. Prandaj dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit nuk mund të shihet si shumë i ashpër. E ky dënim nuk është as shumë i ulët. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar se ka rrethana veçanërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet duke i shqiptuar një dënim i cili është nën kufijtë e përcaktuar me ligj.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme

I.

Ankesa të avokatëve mbrojtës Ljubomir Pantović dhe Miodrag Brkljać janë të paraqitura me kohë dhe të pranueshme.

Kjo ankesë, sidoqoftë nuk është e bazuar.

Pasi që Pika A e aktgjykimit të shkallës së parë – Nxitje e urrejtjes, përçarjes ose e mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik – nuk kontestohet nga mbrojtja, Gjykata Supreme e Kosovës është e kufizuar të merret vetëm me Pikën B – sulm ndaj Policit E. Me këtë sulm i akuzuari ka kryer veprën penale vrasje të rëndë në tentativë dhe një të mëm lëndime të rënda trupore. I akuzuari ka shtënë një herë nga afërsia - ai dhe policit E - ish-in duke qëndruar pranë njëri tjetrit – në viktimën duke e qëlluar në

pjesën e belit. Duke vepruar në këtë mënyrë i akuzuari ka treguar qëllimin e tij për ta privuar nga jeta E. Reflekton njohurinë e përgjithshme se shtënia e një plumbi nga një afërsi e tillë në pjesën e trupit e cila përmban organet vitale dhe arteriet e brendshme e venë jetën e viktimës në rrezik të lartë e cila në asnjë mënyrë nuk mund të kontrollohet nga kryerësi. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me gjykatën e shkallës së parë se vetë veprimet mundësojnë nxjerrje e përfundimeve se i akuzuari në momentin e shtënies ka pasur për qëllim vrasjen e Policit E.

Fakti që i akuzuari kishte plumbin e dytë në pistoletën e tij të cilin ai madje as nuk kishte tentuar ta gjuante nuk është i mjaftueshëm për ta kundërshtuar në mënyrë të suksesshme qëllimin e tij për ta privuar nga jeta E. Fakti vetëm mund të diskutohet nën pyetjen ligjore nëse i akuzuari vullnetarisht ka braktisur kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë në tentativë sipas nenit 22 të KPPK-së. I akuzuari, sidoqoftë, nuk mund të përfitoj nga kjo dispozitë e ligjit. Së pari, sjelljes së tij i mungojnë elementet e vullnetarizmit pasi që polici E pothuajse menjëherë është përgjigjur me zjarr dhe duke vepruar në këtë mënyrë ka zbrapsur të akuzuarin. Së dyti, është e qartë se i akuzuari nuk ka pas për qëllim të shtijë më shumë se një herë në viktimën. Prandaj me këtë të shtënë veprimi i tij është përfunduar me pasojën që ai do të duhej të parandalonte shfaqjen e pasojave – p.sh. vdekja e mundshme e viktimës – në mënyrë që të përfitojë nga dispozita e nenit 22 të KPPK-së. Kjo do të kërkonte një aktivitet specifik nga i akuzuari si, për shembull, ta thërras ambulancën. Duke qëndruar pasiv, duke mos e shtënë plumbin e dytë nuk është e mjaftueshme për ta përmbushur këtë kusht specifik të nenit 22 të KPPK-së.

Pasi që i akuzuari ka kryer veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë nuk mund të shihet si shumë i ashpër. Në të kundërtën, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ky dënim është shumë i butë, siç do të sqarohet më vonë në kontekst me ankesën e palës së dëmtuar E.

Si rezultat, ankesa e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të të akuzuarit nuk është e bazuar dhe duhet të refuzohet sipas nenit 423 të KPPK-së.

2.

Ankesa e paraqitur nga A si palë e dëmtuar është e paafatshme dhe e papranueshme. Aktgjykimi i shkallës së parë i është dorëzuar A më 11 janar 2010. Ankesa e saj është paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë të Mërkurën më 27 janar 2010, dhe prandaj pas skadimit të afatit prej 15 ditësh (shih nenin 398 paragrafin 1 të KPPK-së në lidhje me nenin 95 paragrafin 2 të KPPK-së). Prandaj, ankesa e saj duhet të hedhet poshtë si e paafatshme sipas nenit 420 paragrafit 1 pikës 1 të KPPK-së.

Në pyetjen e ngritur nga avokati mbrojtës Ljubomir Pantović kundër kësaj vetëm gjatë seancës më 4 maj 2010, se a është A palë e dëmtuar apo jo, nuk ka nevojë të jepet përgjigje.

3.

Ankesa e palës së dëmtuar E është paraqitur me kohë dhe është e pranueshme. Gjykata Supreme vëren se E nuk ka paralajmëruar ankesë. Kjo gjë, megjithatë, nuk e bën të papranueshëm këtë mjet juridik. Neni 400, par. 2 i KPPK-së përcakton se nëse personi me të drejtë të ankesës nuk paralajmëron ankesën e tij/saj, do të konsiderohet se ai ose ajo ka hequr dorë nga e drejta për t'u ankuar, përveç në rastet e paragrafit 4 të nenit 400. Paragrafi 4 i kësaj dispozite u referohet rasteve në të cilat i akuzuari është dënuar me burgim.

Në rastin në fjalë, i akuzuari është dënuar me gjashtë (6) vjet e tre (3) muaj burgim. Prandaj, zbatohet paragrafi 4 i nenit 400 të KPPK-së, d.m.th. ankesa nuk ka pasur nevojë që të paralajmërohet.

Ankesa e E gjithashtu është e bazuar. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë është shumë i ulët.

Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit sipas nenit 666, par. 2 dhe 67 të KPPK-së në rastin në fjalë nuk është e përshtatshme. Gjykata e shkallës së parë, zbatimin e kësaj dispozite e ka mbështetur në tri (3) argumente: që i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më herët, që vepra penale ka qenë në tentativë dhe që ai ka qenë në një gjendje të çekuilibruar mendore. Këto arsye nuk janë të mjaftueshme për ta ulur dënimin nga dënimi i mundshëm minimal prej dhjetë (10) vjetësh në një (1) vit burgim. Fakti që vepra penale ka qenë vetëm në tentativë rezulton në zbutjen e dënimit në pajtim me nenin 65, par. 2 të KPPK-së dhe nuk mund që të përdoret herën tjetër për justifikimin e zbatimit të nenit 66 të KPPK-së. Mungesa e të dhënave të mëhershme penale për të akuzuarin mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese, megjithatë e jashtëzakonshme në atë masë sa të lejojë zbatimin e nenit 66 të KPPK-së. E njëjta gjë vlen edhe për gjendjen mendore të të akuzuarit, i cili sipas ekspertizës psikiatrike madje nuk tregon madje as shenja të dobësimi të aftësisë mendore, siç përcaktohet me nenin 12, par. 2 të KPPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës mban qëndrimin që madje as kombinimi i këtyre faktorëve nuk është aq i jashtëzakonshëm sa të përmbushë kushtet e përcaktuara me nenin 66, par. 2 të KPPK-së.

Për këtë arsye, dënimi duhet që të përcaktohet duke zbatuar spektrin e dënimeve të mundshme sipas nenit 147 të KPPK-së, të zbutura në pajtim me nenin 65, par. 2 të KPPK-së – d.m.th. dhjetë (10) vjet burgim apo burgim afatgjatë deri në tridhjetë (30) vjet burgim.

Brenda këtij spektri, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese ashtu siç janë përmendur nga gjykata e shkallës së parë. Duhet të theksojmë që si rrethanë të veçantë rënduese, Gjykata Supreme ka marrë faktin që plumbi është akoma brenda trupit të viktimës dhe nuk ka gjasa që të largohet. Në kundërshtim me mendimin e mbrojtjes, kjo gjë nuk është "pasojë e rëndomtë" e përdorimit të armës së zjarrit, sidomos kur të kihet parasysh fakti që në rastet e vrasjes në tentativë ka mundësi

që plumbi të huq trupin e viktimës. Nga ana tjetër, Gjykata Supreme e Kosovës i ka dhënë rëndësi të posaçme gjendjes mendore të të akuzuarit si një rrethanë lehtësuese. Për këtë arsye, ishte i mundur shqiptimi i dënimit prej dymbëdhjetë (12) vjet burgim ndaj tij, i cili është afër dënimit më të vogël të mundshëm.

Sa i përket dënimit për pikën A – nxitje e urrejtjes, përçarjes dhe mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik – E nuk ka të drejtë ankese pasi që ai nuk është lënduar nga ky veprim i të akuzuarit. Pasi që as mbrojtja nuk e ka kundërshtuar këtë dënim lidhur me këtë pikë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka kompetenca që ta bëjë rivlerësimin e dënimit të shqiptuar për këtë pikë ndaj të akuzuarit.

Në përputhje me dispozitat e nenit 71 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka caktuar një dënim unik prej dymbëdhjetë (12) vjet e tre (3) muaj burgim.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ndryshohet ashtu siç u përshkrua në dispozitiv. Përkitazi me pjesët tjera të aktgjykimit të shkallës së parë, ato vërtetohen në tërësi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
AP – KŽ. Nr. 24/2010

Kryetari i kolegjit

Norbert Koster

Anëtarja e kolegjit

Maria Giuliana Civinini

Anëtari i kolegjit

Guy Van Craen

Anëtarja e kolegjit

Valdete Daka

Anëtari i kolegjit

Avdi Dinaj

